



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.257/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova - kryesuese, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi- anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Enis Maxhuni, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Vushtrrisë, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 20.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesat ZL.Anr.257/2025, dhe ZL.Anr.258/2025 të datës 18.10.2025, të parashtruara nga Enis Maxhuni, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Vushtrrisë, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për vendvotimet: 2705/02, FSHMN “Anton Zako Çajupi” dhe 2731/01 dhe 2731/02, FSHMN “Hajrullah Shehu”, Komuna e Vushtrrisë, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 18.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesat ZL.Anr.257/2025, dhe ZL.Anr.258/2025 nga Enis Maxhuni, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Vushtrrisë, nga radhët e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilat pretendon se ka dyshime për largim të votave në Vendvotimin 2705/02, FSHMN “Anton Zako Çajupi” dhe në Vendvotimet 2731/01 dhe 2731/02, FSHMN “Hajrullah Shehu”, Komuna e Vushtrrisë.

Më tej në ankesë pretendohet se kandidatin në fjalë e kanë votuar z. Feriz Feka me familje si dhe z. Arbnor Feka po ashtu me familje.

Në përgjigjen në ankesë të Komisionin Qendror të Zgjedhjeve – KQZ, sqaron se në përgjigjen e Komisionit Komunal Zgjedhor-KKZ, së Komunës së Vushtrrisë, lidhur me pretendimet e Enis Maxhuni, ZEKKZ deklaron se, sa i përket pretendimeve të ankuesit, për vendvotimet e cekura si në ankesë thekson se është numëruar sipas rregullave dhe procedurave zgjedhore, nga

katër (4) përfaqësues të Subjekteve politike të ndryshme gjë që garanton paanshmëri dhe transparencë të plotë gjatë procesit të numërimit dhe po ashtu nën vëzhgimin e së paku dy (2) vëzhguesve dhe nga Subjekte politike të ndryshme, si dhe kamerat e sigurisë të cilat kanë regjistruar tërë procesin në tavolinën e numërimit .Gjatë numërimit dhe deri në përfundim të tij nuk është ankuar askush nga numëruesit apo vëzhguesit dhe nuk ka pasur vërejtje lidhur me procedurat e numërimit apo përpilimin dhe vendosjen e votave për kandidat në formular zgjedhor (sistem digjital), (shih të bashkangjitur deklaratat e ZEKKZ, për secilin vendvotim).

Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese që mbështeten në deklaratimet e familjarëve dhe miqve, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1,3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova të mjaftueshme që do të mund të dëshmonte apo të mbështeste pretendimet e saj të paraqitura në ankesë.

KQZ, ju njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe -të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet drejtësisë.

Paneli, në kuptim të nenit 6 paragrafi 6 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat ZL.A.nr.257/2025 dhe ZL.A.nr.258/2025 të datës 18.10.2025, të njëjtat janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët ZL.A.nr.257/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës konstaton se:

- Ankesa është e pa bazuar

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, përgjigjes në ankesë të KQZ-së, vlerësoj se pretendimet në ankesat e Enis Maxhuni, kandidat për kuvend komunal në Komunën e Vushtrrisë nga Subjekti Politik LDK, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa se *pretendon se ka dyshime për largim të votave në Vendvotimin 2705/02, FSHMN "Anton Zako Çajupi" dhe në Vendvotimet 2731/01 dhe 2731/02, FSHMN "Hajrullah Shehu", Komuna e Vushtrrisë*, pasi nuk ka arritur që të dëshmoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesat e tij, nga se paraqitësi i ankesave nuk ka bashkëngjitur ankesës asnjë provë dhe nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e tij se i mungojnë votat, ndërsa pretendime e theksuara janë supozime dhe nuk janë dokumentuar me fakte dhe në prova konkrete.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, ashtu siç është përcaktuar me nenin 117 par.3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin ne përcaktohet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, nga përgjigja e KQZ rezulton se gjatë numërimit dhe deri në përfundim të tij, nuk është ankuar askush nga numëruesit apo vëzhguesit dhe nuk ka pasur vërejtje lidhur me procedurat e numërimit apo përpilimin dhe vendosjen e votave për kandidat në formular zgjedhor. Ndërsa, në qoftë se ankuesi has në parregullsi barra e të provuarit bie mbi ankuesin,

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.257/2025, datë 20.10.2025

Kryesues i Panelit
Violeta Husej Rugova



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.